

Konsultimet rajonale me shoqërinë civile mbi Inicativën për themelimin e KOMRA-së

Shkup, Maqedoni

3. qershor 2010.

Fjala është për konsultimet e para mbi Inicativën për themelimin e KOMRA-së, të cilat mbahen në Maqedoni. Konsultimet i ka organizuar Fondi për të Drejtën Humanitare në Kosovë. Në takim marrë pjesë 56 pjesëmarrës/e nga territori i ish RSFJ-së, më së shumti kanë qenë nga Maqedonia. Moderator ishte Veton Muji (Syri i Vizionit, Kosovë). Për konsultimet raportuan, mes tjerëve, TV Kanal 5, Kanal 77, A1 TV, TELMA TV dhe Alb TV.

Opinionet, qëndrimet dhe propozimet e pjesëmarrësve/eve:

Një ndër çështjet kryesore me të cilat duhet të merret komisioni rajonal është satisfaksioni për anëtarët e familjeve të personave të zhdukur. Në kuadër të komisionit duhet formuar nën-këshillet në shtetet të cilat e përbëjnë KOMRA-në.

Mendoj se një ndër çështjet kryesore me të cilat duhet të mirret komisioni rajonal –është pikërisht satisfaksioni për anëtarët e familjeve të personave të zhdukur. Ne në Maqedoni akoma po ballafaqohemi me sindromin, se një numër i qytetarëve të këtij shteti edhe më tutje figurojnë të zhdukur, prandaj, do të thoja se në kuadër të komisionit rajonal, nëse nuk është paraparë deri tani, mendoj se është më së miri të formohen nën-këshillet nacionale në shtetet të cilat e përbëjnë KOMRA-në. (Raim Limani, Shkup, Shoqata e veteranëve të luftës të Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare, Maqedoni, Konsultimet rajonale me shoqërinë civile, Shkup, Maqedoni, 3 qershor, 2010).

Nëse Iniciativa ka sukses, atëherë ajo mund ti frymëzojë shumë vende me situatë të ngjajshme në botë.

(...) nga Ballkani gati se kurrë nuk vjen diçka moderne. Me këtë rast, jo vetëm që është e rëndësishme moralisht dhe faktikisht, historikisht dhe ligjërish, por është një mundësi serioze që tu ndihmohet viktimave, dhe tu ndihmohet njerëzve të rinjë që të mësojnë diçka, por edhe kjo është diçka shumë moderne, nëse do të ketë sukses do të mund ti frymëzojë edhe shumë vende tjera në botë me situatë të ngjashme. (Lazar Stojanović, Fondi për të Drejtën Humanitare, Beograd, Serbi, Konsultimet rajonale me shoqërinë civile, Shkup, Maqedoni, 3 qershor, 2010).

Me vërtetimin e fakteve ngushtohet hapësira e gënjeshtreve, manipulimeve apo zvogëlimit të numrit të viktimave.

Vërtetimi i fakteve është i rëndësishëm që gënjeshttrat e bëra deri më tani ta humbin kredibilitetin e tyre, dhe që shoqëritë në rajon të vijnë deri te kuptimi i përbashkët të asaj se çfarë ka ndodhë. Dhe më këtë ngushtohet hapësira e manipulimit, për zmadhimin apo zvogëlimin e numrit të

viktimave, në rastin konkret të krimeve të luftë dhe krijohet një kuptim i ri. (Marko Veličković, Qendra për zhvillimin e resurseve civile, Beograd, Serbi, Konsultimet rajonale me shoqërinë civile, Shkup, Maqedoni, 3 qershor, 2010).

Viktima janë edhe anëtarët e familjeve të pjesmarrësve të luftës sepse janë të traumatizuar.

Viktimat janë ata që marrin pjesë aktive në luftë, por edhe familjet tona janë viktime, kategoria e viktimave të padukshme sepse të gjithë janë të traumatizuar. Nënkuptohe se anëtarët e familjeve të secilit pjesëmarrës në luftë janë të traumatizuar. (Nikolla Grkov, Shoqata e armatës së veteranëve, Kavadarci, Maqedoni, Konsultimet rajonale me shoqërinë civile, Shkup, Maqedoni, 3 qershor, 2010).

Insistoj që në rajon të formohet një komision me qëllim të vërtetimit të numrit të personave të cilët vuajnë nga çrregullimet post-traumatike të cilët kanë kryer vetëvrasje, si dhe numrin e atyre që janë vrarë nga personat me çrregullime post-stresuese.

Personalisht kam shkruar për stresin post-traumatik, apo i njohur si sindromi i Vietnamit (...) Unë insistoj që të formohet një komision me qëllim të vërtetimit të numrit, numrit të saktë të personave të traumatizuar, numri i saktë i të vrarëve, gjegjësisht të atyre të cilët kanë bërë vetëvrasje si pasojë e traumave dhe të atyre të cilët janë vrarë në rajon nga personat e traumatizuar. (Nikolla Grkov, Shoqata e armatës së veteranëve, Kavadarci, Maqedoni, Konsultimet rajonale me shoqërinë civile, Shkup, Maqedoni, 3 qershor, 2010).

Maqedonët e kanë të vërtetën e tyre për vitin 2001, ndërsa Shqiptarët të tyren.

Maqedonët e kanë të vërtetën e tyre, Shqiptarët e kanë të vërtetën e tyre, të ngarkuar me paragjykime dhe stereotipe, rrallë flasin për këtë temë. Të gjitha diskutimet për ate çfarë ka ndodhë në vitin 2001, si të tejkalohe pasojat, çfarë trajtimi tu ofrohet viktimave, të gjitha këto i kemi lënë në duart e vullnetit politik, gjegjësisht qeverisë dhe partnerëve në koalicion që të pajtohen lidhur me këtë dhe ta sjellin vendimin, gjegjësisht ligji për mbrojtësit dhe a do të ketë ligj për pjesëtarët e UÇK-së. (Frusina Remenski, Fakulteti për siguri, Shkup, Maqedoni, Konsultimet rajonale me shoqërinë civile, Shkup, Maqedoni, 3 qershor, 2010).

Maqedonisë i nevojitet Iniciativa për KOMRA-në.

Nuk ka dyshim se, Republika e Maqedonisë ka nevojë për një Inicativë të tillë. Edhe pse, numri i viktimave të krimeve të luftës nuk është proporcional me ngjarjet e viktimave të cilat i cekët, se kanë ndodhë në pjesët tjera të ish Jugosllavisë. Mendoj se na duhet një Inicativë e tillë që të gjinden përgjegjësit në këto pyetje, madje edhe në çështjet nxitëse në Maqedoni, të ndihmohet në tejkalimin e paragjykimeve dhe barrierave etnike, dhe të mundësohet hapja e një bashkësie përballë tjetrës. (Frusina Remenski, Fakulteti për siguri, Shkup, Maqedoni, Konsultimet rajonale me shoqërinë civile, Shkup, Maqedoni, 3 qershor, 2010).

KOMRA mund ta zgjidhë një numër të madh të rasteve (lëndëve) të cilat publikisht po tentohet të fshehën.

Unë e shikoj me optimizëm këtë proces. Kam pas rast të takohem disa herë me KOMRA-në, e cila për mua është shumë e rëndësishme (Qasja Rajonale mund të na ndihmojë në shumë gjëra, përderisa e kemi Iniciativën e cila do të merrej me konfliktin, luftën, të llojit të Bosnjës, Kroacisë, Kosovës, luftërat e këtyre përmasave. KOMRA mund ti zgjedhë shumë raste (lëndë) të cilat publikisht po tentohet të fshehën, në këtë kuptim mund të ndihmojë shumë. (Boro Kitanoski, Akcioni Paqësorë, Prilep, Maqedoni, Konsultimet rajonale me shoqërinë civile, Shkup, Maqedoni, 3 qershor, 2010).

KOMRA është e domosdoshme, por është edhe një mënyrë për qeveritë në rajon ta hjekin përgjegjësinë nga vetja.

(...) ka shumë arsye për themelimin e komisionit i cili veprimtarinë e tij do ta shtrijë në tërë territorin e ish Jugosllavisë. Nga ana tjetër, kam frikë se ky komision do ta marrë përgjegjësinë e cila u takon shteteve, gjegjësisht komisionit shtetëror. Si mund ta formojnë në KOMRA-në, e cila është e domosdoshme, pa qeveritë në rajon, të cilat një një mënyrë do ta hjekin përgjegjësinë nga vetja e tyre? (Thomas Kohls, Akcioni Paqësorë, Prilep, Maqedoni, Konsultimet rajonale me shoqërinë civile, Shkup, Maqedoni, 3 qershor, 2010).

Në mënyrë që qeveritë e shteteve në rajon të veprojnë sipas rekomandimeve të KOMRA-së, komisioni duhet të jetë organ zyrtar.

(...) ne gjatë tërë kohës po flasim se qëllimi ynë është themelimi i komisionit, i cili do ti ketë katër karakteristika, prej të cilave njëra do të jetë zyrtare (...) në përfundim të punës së saj, ky komision, rajonal, harton raportin përfundimtar i cili do të përmbajë të gjitha faktet e vërtetuara, por i cili do të përmbajë edhe rekomandimet të cilat do tu drejtohen qeverive, themeluesve të saj (...) çfarë hapash duhet të ndërmerren në kuptimin e riparimit, memorialit dhe kështu raporti do të bëhet burimi më kredibil i informatave për sistemet arsimore (...) Por, në mënyrë që qeveritë të kenë obligim më të madh për ti dëgjuar dhe vepruar sipas atyre rekomandimeve, ato duhet që nga fillimi të qëndrojnë krah saj. Do të thotë, puna e (komisionit) jozyrtar (...) nuk do tua jepja këtë përgjegjësi dhe obligim qeverive që ti aplikojnë ato rekomandime. (Marko Veličković, Qendra për zhvillimin e resurseve civile, Beograd, Serbi, Konsultimet rajonale me shoqërinë civile, Shkup, Maqedoni, 3 qershor, 2010).

Ne besojmë në mundësinë e pajtimit mes Maqedonëve dhe Shqiptarëve.

Ne besojmë në mundësinë e pajtimit mes Maqedonëve dhe Shqiptarëve, dhe mendoj se me një aktivitet të tillë mund të tejkalohen përçarjet dhe të nxirren përfundimet për ate se çfarë ka ndodhë në vitin 2001, dhe në bazë të saj gjeneratat e ardhshme të nxjerrin mësim nga kjo. (Aco Jovanski, Unioni Mbrojtës i Maqedonisë, Shkup, Maqedoni, Konsultimet rajonale me shoqërinë civile, Shkup, Maqedoni, 3 qershor, 2010)

Sot në qeveri janë njerëzit të cilët kanë qenë shkaktar të konfliktit. Ata e fshehin të vërtetën për krimet, KOMRA duhet të fuqizohet në mënyrë që të ketë forcën të luftojë kundër tyre, e këtë do ta arrijë me pjesëmarrjen e numrit sa më të madh të njerëzve në Iniciativën për KOMRA-në.

(...) në territorin e ish Jugosllavisë ekzistojnë mbi 50% të njerëzve të cilët kanë qenë shkaktarë të konfliktit, e të cilët edhe më tutje janë në qeveri, dhe sot ata punojnë në fshehjen e të vërtetës që të mos zbulohen krimet. Nëse KOMRA nuk forcohet, nuk do ta ketë mekanizmin apo armën për luftë kundër kësaj. Natyrisht, arma e vetme në dispozicion e KOMRA-së është numri sa më i madh i njerëzve në shenjë përkrahjeje të kësaj Initiative. (Besim Hoda, Lëvizja e qytetarëve EC, Gostivar, Maqedoni, Konsultimet rajonale me shoqërinë civile, Shkup, Maqedoni, 3 qershor, 2010).

Bashkimi Evropian mund ti detyrojë qeveritë t'i gjejnë personat e zhdukur.

(...) na duhet përkrahja e Bashkësisë Evropiane, posaçërisht ti detyrojë qeveritë e të gjitha shteteve për zbulimin e personave të zhdukur. (Armend Mazreku, Lëvizja Fol, Prishtinë, Kosovë, Konsultimet rajonale me shoqërinë civile, Shkup, Maqedoni, 3 qershor, 2010).

Iniciativa për KOMRA-në është fisnike.

(...) tani e kam më të qartë se çka dëshironi të arrini me këtë iniciativë, po, pajtohem me këtë iniciativë fisnike. (Oliver Bacanoviç, Fakulteti për siguri, Shkup, Maqedoni, Konsultimet rajonale me shoqërinë civile, Shkup, Maqedoni, 3 qershor, 2010).

Duhet të ndryshohet legjislacioni penal, që të harmonizohet me KOMRA-në.

(...) këtë duhet ta shikojmë nga aspekti që do të jetë e nevojshme në periudhën e implementimit, madje edhe para, të ndryshohet legjislacioni i caktuar i cili ka të bëjë me përgjegjësinë e krimet, do të thotë legjislacioni penal (...) nëse vërtetohet se dikush ka kryer vepër penale, qartë se vjen deri të individualizimi i përgjegjësisë së tij, dhe si, në çfarë mënyre të delegohet kjo te institucionet ligjore, prokuroritë, policia. (Milena Saviq, CIPP, Zvornik, BeH, Konsultimet rajonale me shoqërinë civile, Shkup, Maqedoni, 3 qershor, 2010).

KOMRA me rekomandimet e saj duhet të ndikoj në ndryshimin e sistemit arsimor.

Dëgjimet publike do të çojnë në ndjeshmëri kolektive.

(...) komisioni (...) ka përgjegjësi shumë të madhe që me kualitetin e saj dhe me rekomandimet e hollësishme, para se gjithash të ndikojë në kahjen e ndryshimit të sistemit të arsimit. Pra, të sistemit të arsimit zyrtar që vepron, pra sipas të cilit do të arsimohen gjeneratat e ardhshme. Dhe mendoj, se këto dëgjimet /seancat publike të cilat janë paraparë (...) do të çojnë në ndjeshmërinë kolektive. (Ivan Novosel, Legalis, Zagreb, Kroaci, Konsultimet rajonale me shoqërinë civile, Shkup, Maqedoni, 3 qershor, 2010).